



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.105

1 korrik

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 26.6.2008	Për vlerësimin e verpimtarisë së Komisionit të Shërbimit Civil për vitin 2007 4589
Rezolutë e Kuvendit datë 26.6.2008	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike për vitin 2007 4590
Dekret nr.5755 datë 9.6.2008	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare 4591
Dekret nr.5772 datë 24.6.2008	Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme për kryetar komune në komunën Kashar, qarku Tiranë..... 4592
Udhëzim i MPPTT nr.7, datë 10.6.2008	Mbi rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit/ve me pagesë në rrugë 4592
Udhëzim i MPPTT nr.8, datë 23.6.2008	Për një ndryshim në udhëzimin nr.20, datë 10.10.2007 “Për modelet e licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar 4603
Udhëzim i MPPTT nr.9, datë 23.6.2008	Për një ndryshim në udhëzimin nr.15, datë 24.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, i ndryshuar 4603
Udhëzim i MPPTT nr.10, datë 23.6.2008	Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së lejeve për ushtrimin e veprimtarisë dhe lejeve të operimit në fushat e transportit detar..... 4604
Udhëzim i MPPTT nr.672, datë 23.4.2008	Për përcaktimin e rregullave teknike për dorëzimin, bërjen të paefektshme për qitje dhe ruajtjen e koleksionit të armëve të ish- Familjes Mbretërore Shqiptare 4611

Vendim i KNSH nr.26, datë 17.6.2008	Për miratimin e udhëzimit “Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik”	4613
Vendim i ERE nr.63, datë 13.6.2008	Mbi aplikimin e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike nga parku eolik Kavajë	4617
Vendim i ERE nr.64, datë 13.6. 2008	Mbi aplikimin e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike nga parku eolik Lezhë	4618
Vendim i ERE nr.67, datë 20.6.2008	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., (park eolik BPGE1)	4619
Vendim i ERE nr.75, datë 26.6.2008	Për përcaktimin e çmimit të shitjes me shumicë të energjisë elektrike	4620
Vendim i ERE nr.76, datë 26.6.2008	Për miratimin e sistemit të njëjtë dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike	4620
Vendim i ERE nr.77, datë 26.6.2008	Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike	4621
Vendim i ERE nr.78, datë 26.6.2008	Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike	4621
Vendim i ERE nr.79, datë 26.6.2008	Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes të tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike	4622
Vendim i ERE nr.80, datë 26.6.2008	Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike	4622
Kërkesë e MPPTT nr.4301, datë 11.6.2008	Për shpronësim publik për pasurinë që preket nga ndërtimi i unazës Shkodër (dy kolektorët dhe sipërfaqet e truallit në banesa)	4623
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Bashkim Aqif Gorovelli	4624
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetases Suzana Stafa	4624

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VERPIMTARISË SË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN
2007

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur rolin e këtij institucioni të pavarur që ligji “Statusi i nëpunësit civil” ka sanksionuar për Komisionin e Shërbimit Civil, si struktura shtetërore që mbikëqyr menaxhimin e shërbimit civil në nivel qendror e vendor;

- duke këmbëngulur në formimin e një performance të plotë të këtij Komisioni për zgjidhjen e ankesave ndaj vendimeve në lidhje me nëpunësin civil;

- duke kërkuar me forcë që Komisioni i Shërbimit Civil të jetë promotor i zhvillimit të reformave në administratën publike, në kuadër të Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të Integritimit në Bashkimin Europian;

- duke theksuar rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve ndër-institucionale ndërmjet Komisionit të Shërbimit Civil dhe institucioneve të tjera ligjvënëse, ekzekutive, gjyqësore dhe atyre të pavarura;

Konstaton:

- gjatë vitit 2007 ky institucion është përpjekur të përmbushë kërkesat e lëna nga Kuvendi me rezolutën e 19 marsit 2007 për zbatimin e detyrave të tij ligjore për sigurimin e një administrate profesionale dhe të paanshme;

- gjatë këtij viti, Komisioni ka pasur një periudhë kohore të vështirë dhe të mosfunksionimit të tij normal, edhe pse ka vijuar shqyrtimi dhe zgjidhja në mënyrë ligjore, objektive dhe transparente të ankesave të nëpunësve civilë ndaj vendimeve të administratës publike, në lidhje me pranimin në shërbimin civil, periudhën e provës, ngritjen në detyrë, lëvizjen paralele, ristrukturimin, vlerësimin dhe të drejtat e tjera që parashikon statusi i nëpunësit civil;

- veprimtaria e Komisionit të Shërbimit Civil, në lidhje me ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve të tij gjatë procesit të ankimit në gjykatë, si dhe puna e nisur për unifikimin e praktikave të deritanishme, ka vijuar në kuadër të zhvillimit të një procesi reformues;

- vërehet një ulje e numrit të ankesave nga nëpunësit e shërbimit civil, në lidhje me vendimet e administratës publike qendrore dhe rritje të ankesave ndaj vendimeve administrative të qeverisjes vendore;

- ushtrimi i kontrolleve për përmbushjen e detyrimit ligjor për mbikëqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil, për institucionet që janë në fushën e veprimit të këtij ligji, është bërë në mënyrë të pjesshme dhe ndjekja e rekomandimeve dhe paralajmërimeve nga ana e institucionit nuk është realizuar;

- afatet ligjore të ankimit dhe zgjidhja e ankesave brenda 30 ditëve nga regjistrimi i ankesës, në shumë raste nuk janë respektuar.

Kërkon për vitin 2008:

- rritjen e efektivitetit në punë për mbikëqyrjen e menaxhimit të shërbimit civil;

- nxitjen e një klime sa më të qëndrueshme në të gjitha nivelet e administratës publike qendrore vendore;

- rritjen e profesionalizimit të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të administratës pranë këtij institucioni në ushtrimin e detyrave të tyre ligjore dhe respektimin e afateve ligjore në trajtimin e ankesave, rritjen e efikasitetit të punës të Komisionit të Shërbimit Civil dhe të çdo anëtarit të tij;

- krijimin e një klime bashkëpunimi efektiv në marrëdhënie me institucionet e tjera e në veçanti me Departamentin e Administratës Publike;

- përmirësimin në nivel të dukshëm të rolit të Komisionit të Shërbimit Civil, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në nivelin e administratës së pushtetit vendor;

- reformimin e veprimtarisë së institucionit për përmbushjen e detyrimeve të Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, me qëllim integrimin në Bashkimin Europian.

26 qershor 2008

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2007**

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur rolin e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike në zhvillimin dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike në vend;
- duke vlerësuar ushtrimin e pavarësisë, që i garanton ligji nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nga Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike;
- duke vlerësuar punën e bërë nga Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregut të energjisë elektrike;
- duke pasur parasysh problematikën e gjerë të tregut të energjisë elektrike;
- duke vlerësuar punën e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike në hartimin e kuadrit ligjor rregullator, për privatizimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);
- duke vlerësuar punën serioze dhe të pavarur të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike në reformën tarifore të energjisë elektrike, të mbështetur në parime moderne e racionale dhe në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare;
- duke vlerësuar masat e marra për liberalizimin e kufirit të konsumit vjetor të energjisë elektrike nga Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike, në kuadër të hapjes së mëtejshme të tregut;
- duke vlerësuar punën e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike në komunikimin me publikun dhe zgjidhjen në kohë të ankesave apo kërkesave të konsumatorëve;
- duke vlerësuar punën e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike në llogaritjen e impaktit në ekonominë shqiptare të 1 kWh të munguar;
- duke vlerësuar menaxhimin e mirë të KESH sha-së në furnizimin më të mirë të mundshëm për kushtet e sistemit elektroenergjetik dhe tregut rajonal;

Kërkon:

- impenjimin maksimal të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike në hartimin në kohë dhe me cilësi të të gjithë kuadrit ligjor rregullator të nevojshëm për realizimin e privatizimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH);
- vëmendje të vazhdueshme të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike në ecurinë e furnizimit të vendit me energji elektrike dhe mënyrën e menaxhimit nga KESH sha-ja të situatës elektroenergjetike;
- nxitjen e institucioneve përgjegjëse për realizimin brenda afateve të caktuara për investimet e nisura në sektorin e energjisë elektrike;
- ofrimin e ekspertizës së saj të kualifikuar sa herë që do të jetë e nevojshme dhe bashkëpunim të ngushtë me institucionet e tjera shtetërore, që lidhen me zhvillimet në tregun e energjisë elektrike;
- insistimin e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike për nxitjen e konkurrencës për alternativa më të vlefshme investimi në burimet ekzistuese të energjisë dhe ato të reja.

26 qershor 2008

**DEKRET
Nr.5755, datë 9.6.2008**

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|--------------------------------------|---|
| 1. Spartak Ylli Megjidi | 21. Agim Pjetër Gjoni |
| 2. Randos Spartak Megjidi | 22. Oliver Gjok Nikolli |
| 3. Mirela Ismet Megjidi (Hoxha) | 23. Enida Destan Wiehler (Doçi) |
| 4. Tefta Fatli Lika (Alidinaj) | 24. Orneta Asllan Veseli (Merkoqi) |
| 5. Natasha Agim Gann (Nikshiqi) | 25. Vjosa Jehon Veseli |
| 6. Beniamin Meidin Muka | 26. Luiza Çelnik Swoboda (Gishto) |
| 7. Adrian Qemal Çaku | 27. Lindita Ferit Gorenca (Halili) |
| 8. Valbona Xheladin Çaku (Dagistani) | 28. Robert Engjëll Gorenca |
| 9. Heldi Adrian Çaku | 29. Elvis Engjëll Gorenca |
| 10. Stivi Adrian Çaku | 30. Thanas Aleks Milo |
| 11. Anisa Shpëtim Kamberi | 31. Sami Gani Huta |
| 12. Dhurata Abas Sasse (Muhaj) | 32. Lumturije Zihni Huta (Begolli) |
| 13. Sefer Xhemal Sehmer (Gjata) | 33. Drin Zenel Sokollari |
| 14. Denada Vaso Deda | 34. Senel Drin Sokollari |
| 15. Flutura Sadik Hifzi | 35. Edison Drin Sokollari |
| 16. Jyrgen Julian Hifzi | 36. Lindita Faslli Sokollari (Dervishi) |
| 17. Luljeta Hasan Memaj | 37. Suzana Sami Pfeuffer (Xhemollari) |
| 18. Michaela Jan Doganci | 38. Agron Vehip Llanaj |
| 19. Jan Martin Jan Doganci | 39. Lonora Stefan Llanaj (Koçollari) |
| 20. Melanie Elis Jan Doganci | 40. Majk Agron Llanaj |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

DEKRET Nr.5772, datë 24.6.2008

PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJËSSHME PËR KRYETAR KOMUNE NË KOMUNËN KASHAR, QARKU TIRANË

Në bazë të nenit 92 germa “gj” të Kushtetutës dhe të nenit 14 pika 4 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zgjedhjet e pjesshme për kryetar komune në komunën Kashar, qarku Tiranë, të zhvillohen ditën e dielë, datë 27 korrik 2008.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

UDHËZIM Nr.7, datë 10.6.2008

MBI RREGULLAT, KRITERET, DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN E SUBJEKTIT QË DO TË KRYEJË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT TË PARKIMIT/VE ME PAGESË NË RRUGË

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 7 “Rregullimi i qarkullimit në qendrat e banuara” pika 8 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

KREU I QËLLIMI DHE PËRKUFIZIME

Neni 1

Qëllimi

1. Ky udhëzim ka për qëllim që, në kuadër të rregullimit të qarkullimit në qendrat e banuara, të përcaktojë:

a) rregullat, kriteret, dokumentacionin dhe procedurën për për zgjedhjen e subjektit, i cili kryen administrimin e shërbimit të parkimit/ve me pagesë në rrugë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

b) format dhe procedurat e bashkëpunimit.

2. Shërbimi i parkimit me pagesë, paraprakisht:

a) duhet të plotësojë fillimisht kërkesat për parkim për automjetet e banorëve, së dyti për automjetet e punonjësve dhe së treti për automjetet e vizitorëve (hapësirat duhet të plotësojnë standardet e kërkuara të parkimit);

b) duhet të rrisë mundësinë e hyrjes për në institucione dhe zona biznesi brenda zonave të banuara.

3. Brenda zonave të banuara duhet të rezervohet parkim për automjetet e banorëve, kryesisht në komplekse parkimi dhe në prona private, duke minimizuar kështu parkimin në rrugë.

4. Parkimi i mjeteve rrugore duhet të zhvillohet duke pasur në konsideratë ambientin ekzistues të zonave të banuara dhe në përshtatje me planet e zhvillimit të rregullimit të territorit.

Neni 2

Objekti

1. Objekt i këtij udhëzimi është administrimi i shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë, sipas nenit 7 pika 8 germa “c” të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të instalimit e mirëmbajtjes së pajisjeve dhe makinerive të parkimeve me pagesë në rrugë, si dhe kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për përzgjedhjen e subjektit, që do të kryejë administrimin e shërbimit të parkimit/ve me pagesë në rrugë.

2. Ky udhëzim nuk zbatohet në rastin kur administrimi i shërbimit të parkimit nëntokësor me pagesë kryhet me koncesion. Në këtë rast zbatohet ligji nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.

Neni 3

Përkufizime

Në zbatim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

Shërbim parkimi me pagesë në rrugë: është shërbimi i parkimit në zonat që me vendim të këshillit vendor janë përcaktuar si zona të parkimit me pagesë. Shërbimi i parkimit me pagesë në rrugë i referohet kategorive të mëposhtme, në të cilat shërbimi i parkimit sigurohet përkundrejt pagesës:

a) Shërbimi i parkimit me pagesë në rrugët urbane kryesore, në të cilat për parkimin e automjeteve janë parashikuar zona ose breza anësore jashtë karrexhatës.

b) Shërbimi i parkimit me pagesë në rrugët urbane dytësore, në të cilat për parkimin e automjeteve janë parashikuar zona të pajisura me korsi karrexhatës.

c) Shërbimi i parkimit me pagesë në zonë të kufizuar, e cila nënkupton sipërfaqet ku të paktën hyrja ose dalja nga parkimi i automjeteve kërkon kalimin e një pengese.

Brez për qëndrime anësore: pjesa e rrugës në anë të karrexhatës, e ndarë me një vijë kufitare të ndërprerë e që përfshin rreshtin e vendeve të qëndrimit dhe korsinë përkatëse të manovrës.

Karrexhata: pjesë e rrugës e destinuar për lëvizjen e mjeteve; ajo është e përbërë nga një ose më shumë korsi lëvizjeje dhe përgjithësisht është e shtruar dhe e kufizuar nga vija anësore.

Parkimi: zonë ose infrastrukturë e vendosur jashtë karrexhatës, e destinuar për qëndrimin e rregulluar ose jo të mjeteve.

Shesh qëndrimi: pjesë e rrugës me gjatësi të kufizuar, në krah dhe jashtë bankinës, e destinuar për qëndrimin e mjeteve.

Zonë shërbimi: zona e territorit të bashkisë/komunës, ku shërbimi i parkimit me pagesë në rrugë organizohet sipas një sistemi teknologjik të caktuar dhe që përbën një njësi të organizimit të shërbimit në të cilën shërbimi ofrohet nga një prej subjekteve të shërbimit. Këshilli vendor mund të caktojë disa zona dhe nënzona shërbimi sipas ndarjes territoriale, duke marrë për bazë kriteret si niveli i diferencuar i tarifës, zona parkimi për rezidentët dhe jo rezidentët etj.

Formë bashkëpunimi: në kuptim të këtij udhëzimi, është çdo marrëdhënie juridike e krijuar ndërmjet bashkisë/komunës dhe subjektit të autorizuar për të ushtruar veprimtarinë në fushën e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Këshilli vendor: është këshilli i bashkisë ose komunës.

KREU II

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 4

Fazat procedurale

Fazat procedurale që duhet të ndiqen nga bashkia/komuna, për të siguruar administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë, janë si më poshtë:

a) Miratimi i zonave të parkimit me pagesë në rrugë nga këshilli vendor.

b) Vendosja e tarifave për shërbimet, si dhe nivelin e kategoritë e tyre, nga këshilli vendor, si dhe zonat e shërbimit.

c) Miratimi i formës së bashkëpunimit me subjektet private dhe përcaktimi i kriterëve bazë

nga këshilli vendor, për përzgjedhjen e personave juridikë për kryerjen e veprimtarisë së administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë.

d) Organizimi i procedurave mbi përzgjedhjen e personave juridikë që do të ofrojnë veprimtarinë e administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë në një zonë të caktuar shërbimi, sipas formës së përcaktuar të bashkëpunimit dhe rregullave e procedurave përkatëse, mbështetur në këtë udhëzim dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

e) Nënshkrimi i kontratës së shërbimit, i akteve për themelimin e shoqërisë së përbashkët, kontratës së agjentit tatimor, ose i çdo lloj tjetër marrëveshjeje të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, midis entit pronar dhe subjektit juridik të përzgjedhur sipas parashikimeve të këtij udhëzimi.

Neni 5

Standardet e parkimit për mjetet rrugore

1. Enti pronar i rrugës i ka të gjitha përgjegjësitë për planifikimin dhe funksionimin e parkimeve. Ai përcakton se ku duhet të jenë parkimet. Organet e pushtetit vendor për rrugët nën juridiksionin e tyre përcaktojnë kërkesat të cilat duhen të plotësohen nga subjektet private për administrimin e shërbimit të parkimit.

2. Enti pronar i rrugës përcakton numrin minimal të vendeve të parkimit pranë qendrave të banuara dhe zonave të ndryshme të biznesit sipas standardeve të parkimit.

3. Çështja fillestare për entin pronar të rrugës për kërkesat e parkimit pranë një zone banimi është që banorët që përdorin mjete rrugore për afat të gjatë (vetjake, në përdorim ose me qira) duhet të kenë akses në një hapësirë parkimi e cila ndodhet në një distancë të përshtatshme nga zona e tyre e banimit.

4. Në lidhje me numrin e automjeteve, dendësinë e popullsisë dhe standardeve të transportit publik në qytete, është praktike të ndahen qytetet në zona të veçanta, të cilat plotësojnë numrin e kërkuar të parkimit afër vendit të punës.

5. Distanca që bëhet në këmbë është një faktor i rëndësishëm në përcaktimin e vendndodhjeve të parkimit.

a) Në zonën e banimit, ekzistuese apo të rindërtuar, të shikohet mundësia për të gjetur hapësira të përshtatshme parkimi, në mënyrë që distanca që bëhet në këmbë të jetë sa më e shkurtër.

b) Parkimi për automjetet e personave me aftësi të kufizuar duhet të jetë sa më afër hyrjeve të ndërtesave.

6. Numri i kërkuar i parkimeve për çdo zonë të banuar duhet të përcaktohet nëpërmjet studimeve që do të kryhen nga entet pronare të rrugëve.

7. Këshillat vendorë për të përcaktuar zonat e parkimeve me pagesë në rrugë:

a) duhet të parashikojnë rezervimin e një numri të caktuar vendesh parkimi për automjetet e personave me aftësi të kufizuar;

b) duhet të parashikojnë rezervimin e një numri të caktuar vendesh parkimi për automjetet e banorëve të një zone të caktuar, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre, në rastet kur situata ndërtimore në zonë nuk është ose nuk mund të zgjidhet ndryshe;

c) duhet të parashikojnë rezervimin e një numri të caktuar vendesh parkimi për automjetet e subjekteve që ushtrojnë një aktivitet të caktuar në atë zonë, me qëllim mbështetjen e aktivitetit kryesor të subjektit dhe për rastet kur situata ndërtimore në zonë nuk është ose nuk mund të zgjidhet ndryshe (parkim i rezervuar);

d) duhet të parashikojnë distancën që bëhet në këmbë nga vendi i parkimit drejt qëllimit të udhëtimit.

Neni 6

Subjektet e autorizuar

Subjekt i administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë janë personat juridikë, vendas apo të huaj;

- subjekte shtetërore;

- subjekte private që kanë objekt dhe ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e transportit dhe shërbimeve të parkimit;
- subjekte të përbashkëta (shtetërore dhe private).

Neni 7

Administrimi i shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë

Administrimi i shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë përfshin administrimin e parkimeve të miratuara përkundrejt pagesës së tarifës, sipas përcaktimeve të bëra për zonën përkatëse të shërbimit. Ky shërbim përfshin:

- a) vendosjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së nevojshme për shërbimin e parkimit me pagesë në rrugë, duke përfshirë investimin sipas teknologjisë përkatëse, sinjalizimin rrugor vertikal dhe horizontal dhe çdo element tjetër që lidhet me këtë infrastrukturë;
- b) sigurimin dhe shpërndarjen e instrumenteve të pagesës dhe lidhja midis tyre me teknologjinë e ofruar;
- c) arkëtimin e të ardhurave nga tarifa dhe pagesa pranë buxhetit të bashkisë/komunës, sipas formës së caktuar të bashkëpunimit;
- d) sigurimin e informimit të publikut;
- e) sistemin e kontrollit të parkimit me pagesë në rrugë.

Neni 8

Organizimi i administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë

Organizimi i administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë bëhet nga bashkia/komuna, në cilësinë e entit pronar i rrugës. Këshilli vendor përcakton:

- a) zonat e shërbimit;
- b) tarifat e shërbimit;
- c) formën e bashkëpunimit, afatin e tij dhe kushtet financiare të bashkëpunimit;
- d) kryerjen e një pjese apo të gjithë elementeve të shërbimit të parkimit me pagesë nga vetë enti pronar apo me formë bashkëpunimi;
- e) kriteret për vlerësimin e propozimeve në procedurën e përzgjedhjes.

Neni 9

Pagesa e kohëqëndrimit

1. Pagesa e kohëqëndrimit në parkime mund të bëhet:
 - pagesë sipas kohëqëndrimit me bileta;
 - pagesë sipas kohëqëndrimit me sistemin parkimetra në rrugë ose në zona publike të përcaktuara;
 - pagesë sipas kohëqëndrimit me sistemin telefoni celulare;
 - pagesa sipas kohëqëndrimit me sisteme të tjera.
2. Modeli i biletave të parkimit, karakteristikat, elementet e sigurisë dhe mënyra e shpërndarjes së tyre përcaktohen nga këshilli vendor.
3. Karakteristikat, elementet e sigurisë të sistemit të pagesës me parkimetra duhet të jenë të miratuara nga organet kompetente, të reflektuara në certifikatën teknike të prodhuesit të aparaturave të sistemit. Homologimi i sistemit të pagesës me parkimetra do të bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit.
4. Kriteret e vendosjes e të mirëmbajtjes së sistemit të pagesës me parkimetra përcaktohen në kontratën e shërbimit, e cila do të lidhet ndërmjet kryetarit të njësisë vendore dhe subjektit fitues.
5. Sistemi i pagesës me telefoni celulare realizohet vetëm nga subjektet e licencuara nga organet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit të operatorit celular.
6. Karakteristikat, mënyra e ndërtimit, elementet e sigurisë së sistemit të pagesës me telefoni celulare përcaktohen nga enti pronar dhe sigurohen nga subjektet e licencuara për ushtrimin e aktivitetit të operatorit celular.

KREU III
KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PËRZGJEDHJEN E SUBJEKTIT

Neni 10

Veprimtaritë në fushën e parkimit me pagesë në rrugë

Veprimtaritë në fushën e parkimit me pagesë në rrugë, në përputhje me nenin 7 të këtij udhëzimi, janë:

- a) administrimi i shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë;
- b) instalimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe makinerive të parkimeve me pagesë në rrugë;
- c) largimi i automjeteve në rast të parkimit të gabuar, ruajtja e automjeteve të larguara për parkim të gabuar dhe dorëzimi te pronari i automjetit.

Çdo subjekt që ushtron veprimtari në fushat e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni, mund të përzgjidhet nga bashkia/komuna për kryerjen e administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë.

Neni 11

Kriteret e përzgjedhjes

1. Mund të paraqesin kërkesë për ushtrimin e veprimtarisë/ve të propozuara nga enti pronar në një zonë të caktuar si zonë parkimi me pagesë në rrugë subjektet që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) të kenë reputacion të mirë;
- b) veprimtaria kryesore e tyre lidhet me administrimin e parkimit me pagesë në rrugë;
- c) paraqesin dokumente të mjaftueshme për të provuar aftësitë e tyre profesionale, për të siguruar shërbimin përkatës;
- d) paraqesin dokumente të mjaftueshme për të provuar aftësitë e tyre teknike, për të siguruar shërbimin përkatës;
- e) paraqesin dokumente të mjaftueshme për të provuar gjendjen e tyre të përshtatshme financiare për të përmbushur investimin përkatës.

2. Subjekti kërkues për ushtrimin e veprimtarisë/ve, sipas nenit 10 të këtij udhëzimi, duhet të përmbushë të gjitha kriteret e mësipërme, në mënyrë që kërkesa e tij të konsiderohet si e plotë dhe e shqyrtueshme.

Kriteri i reputacionit të mirë

Kërkesa për reputacion të mirë plotësohet në rast se personat që do të ushtrojnë veprimtarinë/të e propozuara në përputhje me këtë udhëzim për një zonë të caktuar si zonë parkimi me pagesë:

- nuk janë shpallur fajtorë për krime ose shkelje serioze ligjore, përfshirë dhe krime ose shkelje të natyrës tregtare.

Kërkesa për reputacion të mirë do të quhet e plotësuar edhe për personin ose personat që janë deklaruar të rehabilituar.

Kriteri i aftësisë profesionale dhe teknike për të ofruar shërbimin

Kërkesa për aftësi profesionale plotësohet në rast se personat që do të administrojnë efektivisht dhe në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë/të e propozuara për zonën e caktuar si zonë parkimi me pagesë, provojnë me dokumente zotërimin e njohurive të mjaftueshme juridike, tregtare, financiare dhe teknike për ushtrimin e kësaj veprimtarie dhe/ose instalimin e mirëmbajtjen e pajisjeve dhe makinerive të nevojshme për parkimet në rrugë me pagesë.

Kriteri i gjendjes së përshtatshme financiare

Kërkesa për gjendje të përshtatshme financiare plotësohet kur disponohen burime të mjaftueshme financiare, në cilat garantojnë administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe/ose furnizimit të pajisjeve dhe makinerive të parkimit me pagesë në rrugë për zonën e caktuar si zonë parkimi me pagesë.

Për vlerësimin e gjendjes financiare, autoriteti kompetent merr në konsideratë:

- a) një llogari vjetore të sipërmarrjes së parkimit me pagesë në rrugë dhe/ose furnizimin e pajisjeve dhe makinerive të parkimeve në rrugë me pagesë, kur sipërmarrja ka një veprimtari vjetore dhe kur kjo llogari aplikohet për atë sipërmarrje;

- b) fondet që ajo disponon, duke përfshirë depozitat bankare dhe kapacitetin huamarrës;
- c) asetet (aktivin tregtar);
- d) impiantet dhe shërbimet.

Autoriteti kompetent duhet të pranojë ose të kërkojë, si provë, konfirmimin e gjendjes ose garancinë e lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë që ushtron aktivitet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 12

Dokumentacioni i përzgjedhjes

1. Kërkesa për ushtrimin e veprimtarisë/ve të propozuara, për një zonë të caktuar si zonë parkimi me pagesë në rrugë, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin e mëposhtëm, që vërteton përmbushjen e kriterëve të lartpërmendura:

a) Dëshmi penaliteti për administratorin e shoqërisë dhe kur kërkesa për kompetencë profesionale nuk plotësohet nga administratori i shoqërisë, edhe për drejtuesin teknik të veprimtarisë, i cili e plotëson këtë kërkesë.

b) Dokumenti që vërteton zotërimin e kompetencës profesionale, për administratorin e shoqërisë ose për drejtuesin teknik të veprimtarisë së parkimit me pagesë në rrugë dhe/ose instalimin e mirëmbajtjen e pajisjeve dhe makinerive të parkimeve me pagesë në rrugë për zonën e përcaktuar nga bashkia/komuna.

c) Vërtetim nga gjykata, që tregon se personi fizik apo juridik nuk është shpallur fajtor për shkelje penale dhe ato të natyrës tregtare lidhur me veprimtarinë, objekt i kërkesës, për tre vitet e fundit.

d) Kontratën, me kohëzgjatje të paktën njëvjeçare me drejtuesin teknik të veprimtarisë, që plotëson kërkesën për kompetencë profesionale, për rastet kur kjo nuk plotësohet nga administratori i shoqërisë.

2. Përveç dokumentacionit të mësipërm, subjekti paraqet edhe dokumentacionin si vijon:

a) Vendimin e regjistrimit në regjistrin tregtar të personit juridik, ku në objektin e veprimtarisë të jetë dhe “Administrimi i shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë dhe/ose në zona të caktuara për parkim”.

b) Programin vjetor ekonomiko-financiar dhe të zhvillimit të veprimtarisë për biznesin që do të ushtrohet (planbiznesi).

c) Certifikatën e regjistrimit në organin tatimor.

d) Vërtetimin e gjendjes ose garancinë bankare që vërteton gjendje të përshtatshme financiare sipas parashikimeve të këtij udhëzimi.

3. Në rastin kur subjekti është një bashkim shoqërisë, dokumentacioni duhet të paraqitet nga përfaqësuesi i tyre si një shoqëri e vetme dhe dokumentacioni i përzgjedhjes duhet të përfshijë informacion për të gjitha shoqëritë pjesëmarrëse.

4. Afati i veprimtarive të administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë, është 5-vjeçar me të drejtë rinovimi në rast se subjekti i plotëson të gjitha kriteret e parashikuara në këtë udhëzim dhe nuk ka qenë subjekt i mosshlyerjes së detyrimeve kontraktore apo financiare.

KREU IV

FORMAT DHE PROCEDURAT E BASHKËPUNIMIT

Neni 13

Bashkëpunimi midis njësive vendore dhe subjekteve private

1. Në zbatim të nenit 7, pika 8 germa “c” të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, bashkëpunimi midis njësive së qeverisjes vendore dhe subjektit juridik që do të ngarkohet me kryerjen e administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë, mund të kryhet me një nga format e mëposhtme:

- a) kontratë shërbimi;
 - b) shoqëri e përbashkët;
 - c) koncesion;
 - d) forma të tjera sipas legjislacionit në fuqi, kontratë agjenti tatimor etj.
- Forma e bashkëpunimit përcaktohet me vendim të këshillit vendor.

Neni 14

Kontrata e shërbimit

1. Objekti i kontratës përfshin shërbimin e administrimit të parkimit në rrugë me pagesë sipas parashikimeve të nenit 7, 8 dhe 9 të këtij udhëzimi.

2. Bashkia/komuna, në rastin e administrimit të shërbimit të parkimit me pagesë në rrugë, sipas rastit, duhet të vërë në dispozicion të plotë të subjektit administruar zonën e miratuar për parkim me pagesë në rrugë. Investimi në mjete, makineri dhe pajisje kryhet nga njësia e qeverisjes vendore dhe /ose nga subjekti privat.

3. Përzgjedhja e subjektit privat për të kryer shërbimin bëhet nga bashkia/komuna sipas procedurave të ligjit "Për prokurimin publik".

4. Bashkia/komuna ka të drejtë të ushtrojë kontrollin mbi administrimin e shërbimit të kontraktuar dhe t'i kërkojë subjektit administruar të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të subjektit administruar.

5. Në zbatim të nenit 12 pika 3 germa "c/1" të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, këshilli vendor mund të delegojë shërbimin e kujdesit dhe kontrollit të shfrytëzimit ekonomik të mjetit në vende të veçanta dhe të rrugëve, në subjektin juridik të zgjedhur për të administruar shërbimin e parkimit me pagesë në rrugë.

Neni 15

Krijimi i shoqërisë së përbashkët

1. Krijimi i shoqërisë së përbashkët midis njësisë së qeverisjes vendore dhe subjektit juridik për rastin e parashikuar në nenin 7, pika 8 germa "c", do të bëhet në përputhje me ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" dhe legjislacionit në fuqi.

2. Përzgjedhja e ortakut/aksionarit të njësisë së qeverisjes vendore duhet të bëhet sipas parashikimeve të këtij udhëzimi, përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.

3. Përzgjedhja e ortakut për krijimin e një shoqërie të përbashkët bëhet me konkurrim të hapur. Kriteret e përzgjedhjes së ortakut janë:

- a) Besueshmëria financiare dhe emri i mirë i subjektit konkurrues.
- b) Efektiviteti ekonomik dhe teknik i projektit të propozuar.

Në këtë kriter përshihen, por pa u limituar, teknologjia e propozuar për administrimin e parkimit me pagesë në rrugë dhe aplikimi i tarifës, duke pasur parasysh kryesisht aspektet e mëposhtme, si:

- zgjidhjen teknologjike;
- efektivitetin e kostos dhe atë ekonomik;
- mënyrën e funksionimit të parkimit;
- organizimin e shërbimit;
- aspektin mjedisor dhe harmonizimin me ambientin ekzistues;
- ekuilibrin ekonomik të kërkesës, duke marrë në konsideratë një sërë kriteresh, si:
- përfitimi ekonomik, duke u mbështetur në tarifën e miratuar për shërbimin e parkimit;
- financimin që propozohet të kryhet nga aplikanti;
- të ardhurat e pritshme, si dhe kohëzgjatjen e shfrytëzimit të shërbimit mbi bazën e numrit të vendeve marrë në administrim;

- raportin shpjegues që vërteton përputhshmërinë e projektit të paraqitur me vendimet e këshillit vendor, të cilat përcaktojnë zonat e parkimit me pagesë në rrugë, tarifën, taksat për shërbimet, si dhe nivelin dhe kategoritë e tyre.

- c) Projekti i mbledhjes së tarifave, sigurisë dhe mbikëqyrjes.
- d) Planbiznesi i administrimit të këtij shërbimi.
- e) Oferta ekonomike për bashkëpunim në shoqërinë e përbashkët, që përfshin formën e

shoqërisë, kapitalin dhe ndarjen e përqindjeve të tij, kontributin në para dhe natyrë, pjesëmarrjen në vendimmarrje, kohëzgjatja etj.

Këshilli vendor mund të detajojë kriteret e mësipërme ose të miratojë kritere shtesë dhe të caktojë sistemin e pikëzimit mbi bazën e të cilit kryhet vlerësimi i konkurrentëve.

4. Dokumentacioni bazë që paraqitet nga konkurruesit:

a) Lidhur me besueshmërinë financiare dhe emrin e mirë, subjekti konkurrues paraqet pranë strukturave përkatëse të bashkisë/komunës:

- dokumentin e regjistrimit si person juridik (statut, akt themelimi);
- vërtetim për pagesën e taksave qendrore dhe vendore;
- bilancin e certifikuar nga struktura përkatëse për 2 vitet e fundit (nëse ka aktivitet mbi dy vite);

- konfirmim bankar për gjendjen e likuiditeteve ose formave të tjera të financimit jo më pak se 20 % e vlerës së tij;

- vërtetim që subjekti nuk është në proces falimentimi apo likuidimi;

- emri i mirë tregtar, kontrata të ngjashme dhe referenca për shërbime të kryera nga klientë për këto kontrata.

b) Lidhur me efektivitetin ekonomik dhe teknik të projektit të propozuar, subjekti konkurrues paraqet pranë strukturave përkatëse të bashkisë/komunës:

- projektidenë e zgjidhjes teknologjike nga inxhinierë të licencuar në këtë fushë;
- studimin e fizibilitetit të projektit.

c) Oferta ekonomike.

Neni 16

Forma koncesionare

1. Dhënia e koncesionit nga organet e qeverisjes vendore subjektit juridik, për rastin e parashikuar në nenin 7, pika 8 germa “b”, të ligjit nr.8378 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, do të bëhet në përputhje me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve”, të ndryshuar.

2. Përzgjedhja e subjektit i cili do të bëjë administrimin e shërbimit të parkimit mbitokësor, do të bëhet sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve”, të ndryshuar.

Neni 17

Agjenti tatimor

1. Të drejtat dhe detyrat e agjentit tatimor përcaktohen në ligjin "Për procedurat tatimore".

2. Përzgjedhja e agjentit tatimor bëhet me konkurrim të hapur. Kriteret e përzgjedhjes së agjentit janë:

a) Besueshmëria financiare dhe emri i mirë i subjektit konkurrues.

b) Efektiviteti ekonomik dhe teknik i projektit të propozuar.

Në këtë kriter përfshihen, por pa u limituar, teknologjia e propozuar për administrimin e parkimit në rrugë me pagesë dhe aplikimin e tarifës, duke pasur parasysh kryesisht aspektet e mëposhtme si:

- zgjidhja teknologjike;
- efektiviteti i koston dhe ai ekonomik;
- mënyra e funksionimit të parkimit;
- organizimi i shërbimit;
- aspekti mjedisor, si dhe harmonizimi me ambientin ekzistues;
- ekuilibri ekonomik i kërkesës, duke marrë në konsideratë një sërë kriteresh: si: përfitimi ekonomik, duke u mbështetur në tarifën e miratuarë për shërbimin e parkimit, financimin që propozohet të kryhet nga aplikanti, të ardhurat e pritshme, si dhe kohëzgjatjen e shfrytëzimit të shërbimit mbi bazën e numrit të vendeve marra në administrim.

c) Raporti shpjegues që vërteton përputhshmërinë e projektit të paraqitur me vendimet e

këshillit vendor që përcaktojnë zonat e parkimit me pagesë në rrugë dhe tarifat, taksat për shërbimet, nivelin dhe kategoritë e tyre.

d) Projekti i mbledhjes së tarifave, sigurisë dhe mbikëqyrjes.

e) Planbiznesi i administrimit të këtij shërbimi.

f) Oferta ekonomike, që përfshin vlerën e investimit, përqindjen e agentit, planbiznesi, kohëzgjatja etj.

Këshilli vendor mund të detajojë kriteret e mësipërme ose të miratojë kritere shtesë dhe të caktojë sistemin e pikëzimit mbi bazën e të cilit kryhet vlerësimi i konkurrentëve.

3. Dokumentacioni bazë që paraqitet nga konkurruesit:

a) Lidhur me besueshmërinë financiare dhe emrin e mirë, subjekti konkurrues paraqet pranë strukturave përkatëse të bashkisë/komunës:

- dokumentin e regjistrimit si person juridik (statut, akt themelimi);

- vërtetim për pagesën e taksave qendrore dhe vendore;

- bilancin e certifikuar nga struktura përkatëse për 2 vitet e fundit;

- konfirmim bankar për gjendjen e likuiditeteve ose formave të tjera të financimit jo më pak se 20 % e kontributit të tij;

- vërtetim që subjekti nuk është në proces falimentimi apo likuidimi;

- emri i mirë tregtar, kontrata të ngjashme dhe referenca për shërbime të kryer nga klientë për këto kontrata.

b) Lidhur me efektivitetin ekonomik dhe teknik të projektit të propozuar, subjekti konkurrues paraqet pranë strukturave përkatëse të bashkisë/komunës:

- projektidenë e zgjidhjes teknologjike nga inxhinierë të licencuar në këtë fushë;

- studimin e fizibilitetit të projektit.

c) Oferta ekonomike.

KREU V PROCEDURA E KONKURRIMIT

Ky kre zbatohet vetëm për nenin 15 “Krijimi i shoqërisë së përbashkët” dhe nenin 17 “Agjenti tatimor”.

Neni 18 **Njoftimi**

Bashkia/komuna publikojnë miratimin e zonës së shërbimit, si dhe ftesën për konkurrim në një ose disa gazeta, si dhe në faqen e tyre të internetit.

Neni 19 **Përmbajtja e njoftimit**

Njoftimi duhet të përmbajë të paktën:

a) emrin, adresën e institucionit përgjegjës për shërbimin dhe zyrën në të cilën duhet paraqitur kërkesa;

b) zonat e shërbimit;

c) shërbimin që ofrohet për administrim;

d) karakteristikat kryesore të shërbimit të kërkuar;

e) formën e bashkëpunimit;

f) kohëzgjatjen e kontratës sipas formës së bashkëpunimit;

g) mënyrat kryesore të financimit dhe të pagesës;

h) kriteret e përzgjedhjes dhe sistemin e pikëzimit;

i) përshkrim i dokumentacionit të kërkuar;

j) të dhëna suplementare lidhur me vendin, mënyrën, formën dhe afatin e paraqitjes së kërkesës.

Neni 20

Paraqitja e kërkesës për konkurrim

Subjektet paraqesin kërkesën e tyre për konkurrim brenda afatit të përcaktuar, ashtu siç parashikohet në njoftim.

Neni 21

Komisioni vlerësues

Kryetari i njësisë vendore ngre komisionin vlerësues që përbëhet nga specialistë të fushës. Komisioni vlerësues përbëhet nga një kryetar dhe 4 anëtarë. Komisioni përzgjedh kandidatin fitues.

Neni 22

Vlerësimi i kërkesave për konkurrim

Vlerësimi i kërkesave për konkurrim bëhet në bazë të kritereve dhe sistemit të pikëzimit, të përcaktuar nga ky udhëzim dhe këshilli i bashkisë/komunës.

Neni 23

Shpallja e kandidatit fitues

Komisioni i vlerësimit, brenda 30 ditëve nga dita e afatit të dorëzimit të dokumentacionit, shqyrton dokumentacionin dhe përgatit procesverbalin e vlerësimit të kandidatëve. Procesverbali i vlerësimit të kandidatëve i njoftohet të gjithë kandidatëve konkurrues të cilët kanë të drejtën e ankimimit brenda 10 ditëve nga njoftimi.

Me kalimin e këtij afati dhe shqyrtimin e ankimeve, kryetari i njësisë vendore brenda 10 ditëve shpall kandidatin fitues.

Kandidati fitues ftohet në negociata për kushtet e kontratës ose të dokumenteve për krijimin e shoqërisë së përbashkët.

Në rast të dështimit të negociatave me kandidatin fitues, kryetari i njësisë vendore, brenda 10-ditëve fton për negociim kandidatin e listuar në vend të dytë e kështu me radhë.

Në rastin e krijimit të shoqërisë së përbashkët me kandidatin fitues, zbatohen dispozitat e ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" dhe ligjit "Për shoqëritë tregtare".

KREU VI

SHËRBIMI I DELEGUAR

Neni 24

Shërbimi i deleguar

1. Në rastin kur këshilli vendor vendos të delegojë shërbimin e kujdesit dhe kontrollit të shfrytëzimit ekonomik të mjetit në vende të veçanta dhe të rrugëve te subjekti juridik, ky shërbim përmban:

- a) sigurinë e personave dhe mjeteve që përdorin parkimin me pagesë në rrugë;
- b) sigurinë e këmbësorëve në zonën në fjalë, si dhe të mjeteve që përdorin rrugën publike;
- c) kontrollin, me qëllim shmangien e shkatërrimit apo keqtrajtimit të pajisjeve të teknologjisë së parkimit;
- d) kontrollin e zbatimit të të gjitha rregullave të parkimit me pagesë, ose në vende të parkimit të rezervuar.

2. Për të siguruar shërbimet e deleguara sipas pikës 1 të këtij neni, punonjësit e subjektit të kontraktuar sigurojnë, në përputhje me parashikimet e kontratës lidhur mes palëve, edhe:

- a) Konstatojnë kundërvajtjet në lidhje me parkimin me pagesë, mbajnë procesverbalin e kundërvajtjes dhe njoftojnë policinë e bashkisë/komunës për të marrë masat për dënimin e kundërvajtjes sipas dispozitave të Kodit Rrugor.

b) Subjekti i kontraktuar për një zonë të caktuar dhe që i është deleguar administrimi i shërbimit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, duhet të sigurojë që administrimi i këtij shërbimit të kryhet nga persona të cilët kanë marrë kualifikimin e duhur në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe parashikimet e këtij udhëzimi.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

UDHËZIM
Nr.8, datë 23.6.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.20, DATË 10.10.2007 “PËR MODELET E
LICENCEVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, nenit 5 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

Modeli 114 për “Licencë për kompetencë profesionale në fushën e transportit dhe sigurisë rrugore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

UDHËZIM
Nr.9, datë 23.6.2008

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.15, DATË 24.7.2007 “PËR KRITERET DHE
PROCEDURAT E LËSHIMIT TË LICENCEVE, AUTORIZIMEVE DHE CERTIFIKATAVE
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË TRANSPORTIN RRUGOR”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, nenit 5 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

1. Neni 39/1 “Licencë për kompetencë profesionale në fushën e transportit dhe sigurisë rrugore”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

UDHËZIM
Nr.10, datë 23.6.2008

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT, PEZULLIMIT DHE HEQJES SË
LEJEVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË DHE LEJEVE TË OPERIMIT NË FUSHAT
E TRANSPORTIT DETAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, ndryshuar me ligjin nr.7723, datë 21.6.1993 “Për një shtesë në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991”, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.198, datë 2.5.1997 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.621, datë 20.12.1993 “Për kompetencat në dhënien e lejeve për ushtrimin e veprimtarive në fushën e transportit dhe të komunikacionit”, në Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë, me qëllim rregullimin dhe disiplinimin e marrëdhënieve me subjektet e ndryshme të cilat kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në fushën e transportit detar,

duke adoptuar normat e Bashkimit Europian, Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO) dhe të Organizatës të Kombeve të Bashkuara të zbatueshme në transportin detar të udhëtarëve dhe mallrave;

duke synuar rregullimin, disiplinimin, monitorimin dhe lehtësimin e veprimtarisë së ushtruar ose që kërkohet të ushtrohet nga personat juridikë në fushën e transportit detar, si edhe integrimin e plotë të tyre në tregun europian të transportit detar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

Neni 1
Objekti

Ky udhëzim përcakton kriteret dhe procedurat për lëshimin, pezullimin dhe heqjen e lejeve të veprimtarisë dhe lejeve të operimit, subjekteve juridike që kërkojnë të kryejnë veprimtari në fushat e transportit detar.

Ky udhëzim është i detyrueshëm të zbatohet nga të gjitha subjektet juridike që kryejnë veprimtari në fushën e transportit detar.

Neni 2
Termt

Për qëllimin e këtij udhëzimi, jepen termt që përdoren në transportin detar, të unifikuara me termt e përdorura në direktivat e Bashkimit Europian, rezolutat e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), në marrëveshjet ndërkombëtare bilaterale në transportin detar, si dhe në Kodin Detar të Republikës së Shqipërisë.

1. Ministri: Ministri përgjegjës për transportin.
2. Ministria: Ministria përgjegjëse për transportin.
3. Leje për ushtrim veprimtarie në fushën e transportit detar: është leja që lëshohet nga Ministria mbi bazën e procedurave dhe kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzim.

4. Subjekte juridike në fushën e transportit detar: janë subjekte të shpallura si të tilla me vendim gjykatë (QKR), me objekt veprimtarie në fushën e transportit detar.

5. E drejta e zhvillimit të veprimtarisë në transportin detar me mjet lundrues: është e drejta që fiton një pronar ose operator mjeti lundrues për të kryer transport detar.

6. Pronar mjeti lundrues: është çdo person fizik ose juridik që ka në pronësi ose me kontratë qiraje një ose më shumë mjete lundruese të llojeve të ndryshme.

7. Mjete lundruese: janë të gjitha mjetet lundruese që kanë fituar klasin nga shoqëritë klasifikuese përkatëse dhe janë të afta për të kryer transport detar mallrash dhe ose udhëtarësh.

8. Operim në linjë të rregullt për transport ndërkombëtar për automjete dhe ose udhëtarë: është veprimtaria që ushtrohet për transport automjetesh dhe ose udhëtarëve me mjete lundruese të specializuara për kryerjen e një transporti të tillë, nga një port i hapur i Republikës së Shqipërisë për në një port të huaj.

9. Agjent detar: është çdo subjekt juridik i cili ka fituar një status të tillë dhe vepron si përfaqësues i pronarit ose operatorit të një mjeti lundrues në një port në lidhje me marrëdhëniet që pronari i mjetit lundrues krijon me autoritetet shtetërore dhe ato të shërbimeve në port. Pronari i mjetit lundrues nuk mund të kryejë shërbimin e agjentit detar për anijet e tij.

10. Kapiteneri e portit: është organi përfaqësues i shtetit në çdo port i cili kontrollon zbatimin e ligjshmërisë detare.

11. Regjistri detar shqiptar: është institucioni që inspekton–certifikon të gjitha mjetet lundruese me flamur shqiptar, sipas standardeve teknike dhe të sigurisë.

Neni 3

Dorëzimi, pranimi dhe arkivimi i lejeve

Kërkesat dhe dokumentacioni i personave juridikë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në fushën e transportit detar, dorëzohen në zyrën e licencave të transportit, të caktuara për këtë qëllim nga Ministri ose autoriteti kompetent.

Zyra e licencave, pranon dokumentacionet nga subjektet aplikante vetëm duke u bazuar në rregullsinë ligjore të tyre në zbatim të këtij udhëzimi.

Dokumentet e një subjekti quhen zyrtarisht të dorëzuara duke filluar nga data kur subjekti i ka plotësuar ato në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi dhe i ka protokolluar në zyrën e licencave.

Dokumentet për rinovimin e lejeve paraqiten 30 ditë para afatit të përfundimit të vlefshmërisë së tyre.

Zyra e licencave, përgatit materialin për dhënien e lejeve vetëm për ato subjekte të cilat kanë plotësuar dokumentacionin sipas kërkesave të këtij udhëzimi. Materiali duhet të jetë i plotë dhe të pasqyrojë me hollësi të gjitha elementet e nevojshme për dhënien e lejes për veprimtarinë përkatëse. Ky material shqyrtohet nga eprori/eprorët përkatës dhe miratohet prej tij/tyre. Materiali i përgatitur kthehet në vendim pasi miratohet nga ministri ose autoriteti kompetent. Vendimi bëhet në dy kopje. Zyra e licencave, mbi bazën e vendimit, përgatit formatet e lejeve, sipas standardeve të miratuara.

Data e lëshimit të lejes është data e nënshkruar nga ministri ose autoriteti kompetent.

Lejet që lëshohen sipas emërimit të këtij udhëzimi, janë subjekt i pagesës në llogarinë e autoritetit kompetent që i lëshon ato, në bazë të tarifave të miratuara.

Formatet e lejeve për çdo veprimtari në fushën e transportit detar janë dokumente standard dhe miratohen nga ministri.

Zyra e licencave mban shënime të plota në një regjistër vjetor të dorëzimit të praktikave të subjekteve dhe të dhënies së lejeve.

Zyra e licencave mbi bazën e vendimit, përgatit lejet në dy kopje origjinale, njëra prej të cilave pas nënshkrimit i dorëzohet subjektit përkatës e vulosur, ndërsa tjetra ruhet për arkivim.

Zyra e licencave, arkivon praktikën në bazë të veprimtarive përkatëse, duke mbajtur shënimet e duhura të arkivimit dhe dorëzimit të tyre. Dokumentacioni ruhet në këtë zyrë për një periudhë trevjeçare dhe më pas dorëzohet në arkivin qendror të autoritetit kompetent.

Neni 4

Veprimtaritë e transportit detar

Veprimtaritë e transportit detar për marrjen e lejes nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit janë si më poshtë:

1. Leje për operim në linja të rregullta ndërkombëtare detare për transport automjeteve dhe ose udhëtarësh.
2. Leje për ushtrimin e veprimtarisë së pilotimit dhe ormerxhimit.
3. Leje për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbeturinave të ngurta dhe vajore në portin detar të Durrësit dhe në radën përkatëse.
4. Leje për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbeturinave të ngurta dhe vajore në portet detare të Vlorës, Shëngjinit, Sarandës dhe në radat përkatëse.
5. Leje për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të shërbimit të pajisjeve të sigurimit të jetës në det.
6. Leje për ushtrimin e veprimtarisë së survejimit të mjeteve lundruese.

Neni 5

Kërkesa për marrjen e lejes për operim në linja të rregullta ndërkombëtare detare për transport udhëtarësh dhe ose automjeteve

Kanë të drejtë të operojnë në linja të rregullta ndërkombëtare detare për transport udhëtarësh dhe ose automjeteve, subjektet që kanë marrë lejen e veprimtarisë në transportin detar të përmendura në nenin 5 dhe që paraqesin dokumentet e mëposhtme:

A. Subjektet juridike të regjistruara në Shqipëri

1. Formatin e autodeklarimit
2. Dokumentet e anijes (bashkëlidhur formatit të autodeklarimit):
 - dëshminë e pronësisë së anijes,
 - dëshminë e flamurit,
 - certifikatën e klasit,
 - certifikatën e konstruksionit,
 - certifikatën e tonazhit,
 - certifikatën e vijës së ngarkesës,
 - certifikatën e ndotjes së ambientit,
 - certifikatën e radios,
 - certifikatën e ISM,
 - certifikatën e ISPS,
 - policën e sigurimit të anijes.

3. Regjistrimin në QKR

4. Kontrata me portet që do të prekë anija, së bashku me aneksin për ditët dhe oraret e prekjës

5. Itinerari i linjës

6. Kontrata me një agjenci detare në portin që prek

B. Subjektet e huaja

1. Formatin e autodeklarimit

2. Dokumentet ligjore për statusin si pronar anije, ose statusi si subjekt që ka marrë me qira anijen ose anijet për operim. (Këto dokumente duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara).

3. Dokumentet e anijes (bashkëlidhur formatit të autodeklarimit):

- certifikatën e regjistrimit,
- certifikatën e klasit,
- certifikatën e konstruksionit,
- certifikatën e tonazhit,
- certifikatën e vijës së ngarkesës,
- certifikatën e ndotjes së ambientit,
- certifikatën e radios,

- certifikatën e ISM,
- certifikatën e ISPS,
- policën e sigurimit të anijes.

4. Kontrata ndërmjet pronarit (ose operuesit) me agjencinë detare në portin që prek.

5. Vërtetim për regjistrimin në Dhomën e Detarisë ose të Tregtisë (përkthyer dhe noterizuar).

6. Kontrata me portet që do të prekë anija, së bashku me aneksin për ditët dhe oraret e prekjës.

7. Itinerari i linjës.

Shënim.

- Kontrata me portin që prek (kjo kontratë mund të firmoset edhe nga agjenti detar mbi bazën e një prokure të lëshuar nga kërkuesi).

- Subjektet të cilat operojnë në linjat ndërkombëtare detare dhe kanë prekje në portet përkatëse, çdo ditë të javës duhet minimalisht ta prekin atë port 10 (dhjetë) herë në muaj. Ndërsa subjektet të cilat operojnë në linjat ndërkombëtare detare dhe kanë prekje në portet përkatëse 5 (pesë) herë në javë e më pak, duhet minimalisht ta prekin atë port 5 (pesë) herë në muaj.

- Nuk lejohet zëvendësimi i anijeve katamaran me anije traget dhe anasjellas.

- Lejet për veprimtarinë e pikave “A” dhe “B”, të nenit 6, jepen si rregull me vit kalendarik (1 janar–31 dhjetor) me afat njëvjeçar. Përfshirë nga viti kalendarik bëhet për linjat e reja detare ose për ato linja ku lejet e dhëna janë anuluar dhe nuk operon më asnjë subjekt, ose për interesa të veçanta shtetërore.

- Përfshirë mund të bëhet edhe për rastet kur subjektet operuese në një linjë nuk plotësojnë kërkesat e udhëtarëve dhe transportuesve nga porti detar përkatës. Me kërkesë të argumentuar të këtij porti detar, Ministria merr vendim për licencim, rinovimin e licencës ose jo të subjekteve të reja në këtë linjë, kur ato kanë paraqitur kërkesë me shkrim.

Neni 6

Ndryshimi i anijes, shtesa anijesh ose prekjet ekstra në një linjë të miratuar

Në rastet e zëvendësimit të anijeve dhe/ose shtimit të tyre në të njëjtën linjë, subjekti duhet të lidhë kontratë me portin që prek, më pas duhet të sjellë kontratën së bashku me dokumentet e mjetit për të kryer kontrollin e vërtetësisë së dokumenteve ose të afatit të skadimit të tyre në ministri. Kapitaneria e portit duhet të lejojë operimin pasi të njoftohet nga ministria mbi rregullsinë e dokumenteve.

Në rastet e prekjeve shtesë në të njëjtën linjë do të ndiqen të gjitha procedurat për prekjet shtesë. Në këto raste nuk ka nevojë për lejë nga ministria, por mjafton të njoftohet portit që prek dhe kapitaneria përkatëse për të kryer kontrollin e vërtetësisë së dokumenteve ose afatit të skadimit të tyre. Numri i prekjeve ekstra në të njëjtën linjë nuk duhet të jetë më shumë se 5 (pesë) prekje në muaj, nga i njëjti subjekt i licencuar.

Neni 7

Transportet detare turistike

Transport detar turistik me anije quhet ai transport jo në linjë të rregullt që kryhet me një numër të caktuar pasagjerësh dhe ku nuk lejohet lënia e përhershme dhe imbarkimi i pasagjereve jashtë listës së deklaruar.

Ky transport kryhet pa licencë nga ministria kundrejt të gjitha taksave portuale dhe njoftimit në port dhe kapitenari të listës së deklaruar të pasagjerëve si dhe të dokumentacionit të anijes.

Neni 8

Kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së pilotimit dhe ormerxhimit

Subjekti paraqet:

1. Formatin e autodeklarimit.
2. Dëshminë e aftësisë për pilot (certifikatën e pilotit).

3. Në rastet kur do të punësojë pilot, paraqet edhe kontratën e punësimit të pilotit.
4. Kontratën e punësimit (mbi një vit) të pilotit ose subjektit që punëson pilot me ormerxhatorët.
5. Vërtetimin nga qendra e banimit.
Leja, për herë të parë, jepet me afat 1-vjeçar (njëvjeçar), në rast përsëritje me afat 3-vjeçar (trevjeçar).
Shënim.
 - Nuk lejohet që një pilot të kryejë aktivitete të tjera në fushat e transportit detar.
 - Piloti do të punojë vetëm në portin për të cilin ka marrë dëshminë e aftësisë si pilot (certifikatën e pilotit).

Neni 9

Kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së stacionit të shërbimit të pajisjeve të sigurimit të jetës së njeriut në det

Subjektet duhet të paraqesin:

1. formatin e autodeklarimit;
2. certifikatën e stacion shërbimit nga një shoqëri autorizuese për këtë aktivitet;
3. certifikatën e një shoqërie autorizuese për personelin e autorizuar që do të punojë në stacion e shërbimit;
4. kontratën për furnizim periodik nga kompani prodhuese, për pajisjet e brendshme të zadrave;
5. vërtetimin nga regjistri detar shqiptar, në të cilin të theksohet se plotësohen kushtet e rezolutës A.761 (18) të IMO-s, “Rekomandime mbi kushtet për aprovimin e një stacioni shërbimi për trape shpëtimi me fryrje”;
6. dokumentet e pronësisë mbi objektin (Zyra dhe stacionin) dhe genplanin, kontratën e qiramarrjes së noterizuar.
Leja për herë të parë jepet me afat 1-vjeçar (njëvjeçar); në rast përsëritje me afat 1 vjeçar (njëvjeçar).

Neni 10

Kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbeturinave të ngurta dhe vajore në zonën portuale të Durrësit dhe në radën përkatëse

Që një subjekt të marrë licencën për tërheqjen e mbeturinave të ngurta dhe vajore në zonën portuale të Durrësit dhe në radën përkatëse duhet të paraqesë:

1. formatin e autodeklarimit;
2. licencën për ushtrimin e aktivitetit, të dhënë nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
3. dëshminë e pronësisë të mjetet tokësore të mëposhtme:

a) autobot	copë 3;
b) automjet teknologjik të trajtimit të mbetjeve urbane	copë 3;
c) automjet riportabël për mbledhjen e mbetjeve urbane	copë 1.

Shënim. Për mjetet e mësipërme t'i bashkëlidhet formatit të autodeklarimit: leja e qarkullimit dhe kontrolli i fundit teknik.

4. dëshminë e pronësisë së mjeteve detare të mëposhtme:

a) anije për grumbullimin e mbeturinave të ngurta dhe vajore, e pajisur me një tanker për grumbullimin e mbeturinave vajore, me kapacitet minimum 2 tonë	copë 1;
b) anije për pastrimin e zonave portuale detare dhe radat përkatëse nga vajrat dhe hidrokarburet.	copë 1;
c) lançë e vogël	copë 1.

Shënim. Për mjetet e përcaktuara në pikat a dhe b t'i bashkëngjitet formatit të autodeklarimit: dëshmia e pronësisë, dëshmia e flamurit dhe certifikata e klasit.

Leja për herë të parë jepet me afat 1-vjeçar (njëvjeçar); në rast përsëritje me afat 3-vjeçar (trevjeçar).

Neni 11

Kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbeturinave të ngurta dhe vajore në zonat portuale të Vlorës, Shëngjinit, Sarandës dhe në radat përkatëse

Që një subjekt të marrë licencën për tërheqjen e mbeturinave të ngurta dhe vajore në zonat portuale të Vlorës, Shëngjinit, Sarandës dhe në radat përkatëse duhet të paraqesë:

1. formatin e autodeklarimit;
2. të jenë të pajisur me licencë për ushtrimin e aktivitetit nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave;
3. dëshminë e pronësisë ose kontratën e qirasë të mjeteve tokësore të mëposhtme:
 - a) autobot për grumbullimin e mbeturinave vajore copë 1;
 - b) automjet për grumbullimin e mbetjeve urbane copë 1.

Shënim. Për mjetet e mësipërme t'i bashkëlidhet formatit të autodeklarimit: leja e qarkullimit dhe kontrolli i fundit teknik.

4. Dëshminë e pronësisë ose kontratën e qiramarrjes së mjeteve detare të mëposhtme:
 - a) anije për grumbullimin e mbeturinave të ngurta dhe vajore e pajisur me një tanker për grumbullimin e mbeturinave vajore, me kapacitet minimumi 2 tonë copë 1;
 - b) lançë e vogël copë 1.

Shënim. Për mjetet e përcaktuara në pikën "a", t'i bashkëngjitet formatit të autodeklarimit: dëshmia e pronësisë, dëshmia e flamurit dhe certifikata e klasit.

Leja për herë të parë jepet me afat 1-vjeçar (njëvjeçar); në rast përsëritje me afat 1-vjeçar (njëvjeçar).

Neni 12

Kërkesat për ushtrimin e lejes së veprimtarisë së survejimit të mjeteve lundruese

Licenca për ushtrimin e veprimtarisë së survejimit të mjeteve lundruese u lëshohet personave fizikë dhe juridikë.

Subjektet duhet të paraqesin:

1. formatin e autodeklarimit;
2. Curriculum Vitae (CV) të detajuar të tij;
3. dokumente që të vërtetojnë punësimin në një kompani menaxhimi anijesh;
4. diplomën e mbarimit të shkollës së lartë (inxhinier mekanik);
5. eksperiencë pune në kantierin detar shqiptar prej 5 vjetësh.

Leja për herë të parë jepet me afat 1-vjeçar (njëvjeçar); në rast përsëritje me afat 3-vjeçar (trevjeçar).

Neni 13

Pavlefshmëria dhe heqja e lejeve

Lejet për aktivitetin e transportit bëhen të pavlefshme kur:

1. Ka përfunduar afati i vlefshmërisë.
2. Në rast se subjektet juridike nuk e fillojnë veprimtarinë për të cilën u janë dhënë këto leje brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të tyre ose ndërpret veprimtarinë për më shumë se 30 ditë.

Lejet hiqen nga autoriteti kompetent që e ka lëshuar atë, në rastet:

1. Kur subjekti juridik falsifikon ose bën ndryshime të paligjshme në lejen e veprimtarisë së miratuar. Në këtë rast, ndaj subjekteve ndiqen dhe procedurat ligjore të parashikuara në ligj.
2. Kur vërtetohet se subjekti juridik ka paraqitur deklarime të pavërteta, informacion jo të

saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e lejes së veprimtarisë.

3. Kur subjekti nuk respekton detyrimet që rrjedhin nga leja e veprimtarisë (itinerarin, oraret, prekjat).

4. Kur nuk zbaton kushtet e kontratës së lidhur me portin detar.

5. Kur nuk zbaton rregullat e vendosura nga kapiteneria e portit.

6. Kur nuk tërhiqet në një afat brenda 20 ditëve nga data e lëshimit të tyre.

Nëse leja e veprimtarisë hiqet si rezultat i një prej shkeljeve të mësipërme, subjekti nuk pajiset me leje veprimtarie për një periudhë jo më pak se 2 (dy) vjet.

Neni 14

Dispozita transitorë dhe të fundit

1. Udhëzimi i Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr.21, datë 24.12.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së lejeve për ushtrimin e veprimtarisë dhe lejeve të operimit në fushat e transportit detar” dhe të gjitha aktet e tjera të kësaj Ministrie që bien ndesh me këtë udhëzim, shfuqizohen.

2. Lejet e dhëna sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr.142, datë 20.1.1998 “Për procedurat dhe kriteret që do të zbatohen për marrjen e lejeve për ushtrimin e veprimtarisë në fushat e transportit”, siç është ndryshuar, dhe të udhëzimit të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr.21, datë 24.12.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së lejeve për ushtrimin e veprimtarisë dhe lejeve të operimit në fushat e transportit detar” do të vazhdojnë të jenë në fuqi brenda afatit të tyre të vlefshmërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Ollashi

UDHËZIM

Nr.672, datë 23.4.2008

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE PËR DORËZIMIN, BËRJEN TË PAEFEKTSHME PËR QITJE DHE RUAJTJEN E KOLEKSIONIT TË ARMËVE TË ISH- FAMILJES MBRETËRORE SHQIPTARE

Në mbështetje të paragrafit 4 të nenit 102 të Kushtetutës, e në zbatim të nenit 7 pika 2 germa “c” të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” e të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.211, datë 21.2.2008 “Për mënyrën e trajtimit të koleksionit të armëve të zjarrit të ish-Familjes Mbretërore”,

UDHËZOJ:

1. Strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit t’i bëjnë dorëzimin e koleksionit privat të armëve

të lehta të zjarrit përfaqësuesit të trashëgimtarëve të Familjes së Mbretit Zog, si dhe të ndjekin e kontrollojnë në vazhdimësi masat për ruajtjen e sigurimin e tyre.

2. Në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë të ngrihet Komisioni për dorëzimin e koleksionit privat të armëve të zjarrit të ish-Familjes Mbretërore Shqiptare, me këtë përbërje:

- | | |
|---|-------------|
| a) Zëvendësdrejtori për Rendin Publik | përgjegjës, |
| b) Shefi i Sektorit të Rendit Publik | anëtar, |
| c) Shefi i Seksionit të Armatimit | anëtar, |
| d) Specialisti i Sektorit të Rendit Publik për SHRSF-të | anëtar, |
| e) Specialisti i Seksionit të Armatimit | anëtar. |

2.1 Ky komision ngarkohet me këto detyra:

a) Të bëjë inventarizimin dhe vlerësimin e koleksionit të armëve të lehta, që ndodhen në depon e armatimit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë.

b) Të verifikojë plotësimin e kushteve për ruajtjen e koleksionit të armëve nga trashëgimtarët e Familjes Mbretërore sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.211, datë 21.2.2008 “Për mënyrën e trajtimit të koleksionit të armëve të zjarrit të ish-Familjes Mbretërore” dhe në përfundim, pas plotësimit të tyre, ta dorëzojë këtë koleksion te magazinieri e përfaqësuesi i ish-Familjes Mbretërore Shqiptare.

3. Municionet e bllokuara me koleksionin të ruhen dhe administrohen nga strukturat e Policisë së Shtetit, të ndara me lloje dhe cilësi veprimi, në llogarinë kryesore “model 28” që përdoret nga strukturat e policisë, në një kolonë të veçantë, pa të drejtën e dhënies për kompletim të këtyre armëve. Për efekt ekspozimi, me kërkesë të palës së interesuar, për secilin lloj municioni mund të dorëzohen 2-3 copë fishekë, pasi ato të jenë shpuar në gëzhjojë dhe hequr baruti.

4. Magazinimi, ekspozimi e ruajtja e këtij koleksioni në mënyrë të përhershme të jetë në mjedisin e vendbanimit të ish-Familjes Mbretërore në Tiranë. Magazina të jetë e veçantë, e siguruar me zgarë (rrjetë) hekuri në dyer e dritare (ose të blinduara) dhe ndërtuar me mure e tavan, prej tulle, betoni ose guri me trashësi mbi 50 cm.

4.1 Në magazinë të çelet dhe mbahet libri “model-34” për regjistrimin e armatimit. Hyrja dhe dalja e armëve jashtë magazinës për të gjithë koleksionin apo të një pjese të tij të kryhet duke bërë shënimet përkatëse në libër, kundrejt firmës së dorëzuesit dhe marrësit në dorëzim.

5. Ish-Familja Mbretërore të lidhë kontratë me një nga shoqëritë e ruajtjes e sigurisë fizike të licencuar për administrimin dhe ruajtjen e këtij koleksioni armësh, e cila cakton punonjës shërbimi, sipas përkufizimeve dhe kriterëve të vendosura në nenin 2/3 e 15 të ligjit nr.8770, datë 19.4.2001 “Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike”. Këta punonjës ngarkohen me detyra dhe përgjegjësi sipas neneve 13 e 18 të këtij ligji.

6. Armët e këtij koleksioni të bëhen të paefektshme për qitje përpara dorëzimit të tyre nga specialistët e armatimit në prani të marrësit në dorëzim, duke iu hequr gjilpërat nga shuli. Këto gjilpëra të ruhen në magazinën e armatimit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, në një kasafortë metalike të veçantë të mbyllur me çelës dhe të vulosur.

7. Armët në magazinë të vendosen në kasaforta metalike (dollap hekuri) ose në armaturë druri, duke iu kaluar nëpërmjet urëzës mbrojtëse të këmbëzës së shkrepjes një zinxhir metalik (kavo) në secilën armë. Zinxhiri në dy skajet fundore të jetë i siguruar me dry, duke u kapur me kapse metalike të futura në mure.

8. Në rastet kur armët me vlera muzeale, sipas përcaktimit të Qendrës Ndërkombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore, do të ekspozohen në ambientet e brendshme të ish-Familjes Mbretërore, të kryhen veprimet duke i pasqyruar në librin “model 34” të magazinës. Në këto raste, armët do të vendosen në rresht e të sigurohen me zinxhir metalik sipas pikës 7 të këtij udhëzimi.

9. Në rastet kur armët, për arsye të ndryshme, duhet të dalin e transportohen jashtë ambienteve të përcaktuara në pikën 4 të këtij udhëzimi, lëvizja e tyre të bëhet vetëm me lejë (autorizim) të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Për armët të cilësuar si objekte të trashëgimisë kulturore të jetë marrë më parë leja e Ministrit të Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve.

10. Llogaria dhe dokumentimi i këtyre armëve të mbahet në librin e llogarisë kryesore “model 28” nga sektori i armatimit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë sipas këtij udhëzimi dhe legjislacionit në fuqi, duke e trajtuar dhe konsideruar këtë koleksion armatimi, si të një nënreparti policie të veçantë.

11. Inventari i armatimit të këtij koleksioni të kryhet jo më pak se një herë në vit, nga Sektori i

Armatimit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, me komision të posaçëm, duke respektuar procedurat dhe rregullat për armët organike në përgjithësi.

12. Ndalohet mbajtja dhe përdorimi i armëve të këtij koleksioni nga çdo person i ish- Familjes Mbretërore dhe personave të tjerë në kundërshtim me këtë udhëzim dhe aktet normative në fuqi.

13. Sektori i Policisë së Rendit dhe ai i Armatimit të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Tiranë, sipas juridiksionit, kanë për detyrë dhe të drejtë të kontrollojnë në çdo kohë respektimin dhe zbatimin e rregullave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.211, datë 21.2.2008, në këtë udhëzim, në aktet e tjera ligjore, si dhe mënyrën e kryerjes së shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.

14. Për rastet kur strukturat e Policisë së Shtetit kanë arsye të bazuara në prova se ndodhemi para një rreziku të cenimit të rëndë të rendit dhe sigurisë publike, që bëjnë të pamundur ruajtjen dhe miradministrimin e këtij koleksioni ose konstaton shkeljen e rregullave për ruajtjen dhe administrimin e tij, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë të realizohet ndërhyrja dhe marrja në ruajtje e këtij koleksioni deri në rregullimin e kushteve apo të situatës.

15. Në rastet kur konstatohen shkelje të rregullave për ruajtjen, miradministrimin dhe përdorimin e armëve të këtij koleksioni, ndaj personave përgjegjës të merren masat përkatëse sipas akteve normative në fuqi.

16. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ngarkon personat përgjegjës për të marrë takim me përfaqësues të Oborrit Mbretëror, me qëllim zbatimin e këtij udhëzimi, njohjen me detyrimet e kërkesat e tij, si dhe në vazhdim për ndjekjen e zbatimit të detyrave, monitorimin dhe plotësimin e kushteve të përcaktuara për të bërë të mundur vendosjen e sigurimin e koleksionit të armëve në magazinë.

17. Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen strukturat e përkatëse të Policisë së Shtetit.

18. Me kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

VENDIM
Nr.26, datë 17.6.2008

PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT
“PËR NDIHMËN SHETETËRORE NË FORMËN E KOMPENSIMIT TË
SHËRBIMEVE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM EKONOMIK”

Në mbështetje të nenit 17 shkronja “e” të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, Komisioni i Ndihmës Shtetërore

VENDOSI:

1. Miratimin e udhëzimit “Për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli

UDHËZIM
PËR NDIHMËN SHETETËRORE NË FORMËN E KOMPENSIMIT TË
SHËRBIMEVE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM EKONOMIK

Hyrje

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kushteve dhe kritereve, në përputhje me të cilat mund të lejohet ndihma shtetërore për shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik.

Në terma ekonomike, koncepti i shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik është i lidhur ngushtë me atë të “detyrimeve të ofrimit të shërbimit publik”, pra të detyrimeve që iu vendosen një ose më shumë ndërmarrjeve të një sektori të caktuar, për të furnizuar mallra, ose për të ofruar shërbime tek të gjithë qytetarët, mbi baza jodiskriminuese.

Në të vërtetë, shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik kanë të bëjnë veçanërisht me qytetarë të kategorive të caktuara (si p.sh. të sëmurët, në rastin e disa shërbimeve mjekësore, apo ata që jetojnë në zonat e prekura nga fatkeqësi natyrore, kur rasti është i tillë). Sigurisht, ka edhe shërbime të tjera të përgjithshme, si: arsimi, kultura apo shëndetësia, që i takojnë popullatës në tërësi. Ndërsa detyrimi i ofrimit të shërbimit publik përgjithësisht vendoset në sektorë të tillë si: telekomunikacioni, posta, televizioni/media elektronike, furnizimi me ujë, energji apo gaz, hekurudhat etj. Organet shtetërore duhet të përcaktojnë qartë se cilat do të konsiderohen prej tyre shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik, apo shërbime publike.

Arsyet kryesore për të cilat autoritetet publike vendosin detyrimin e ofrimit të shërbimit publik lidhen me përmbushjen e objektivave politikë dhe shoqërorë, të cilat në pjesën më të madhe të rasteve mund të jenë joefiçent. Detyrimi i ofrimit të shërbimit publik u vendoset ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këta sektorë, me qëllim që të gjithë qytetarët, përfshirë edhe ata që nuk janë në gjendje të përballojnë çmimet e tregut, të kenë të drejtën e furnizimit me këto mallra apo të përfitimit të këtyre shërbimeve.

Për sa kohë që përfitimi për ndërmarrjet mund të jetë më i ulët se përfitimi social, autoritetet publike ndërhyjnë për të kompensuar fitimin e munguar dhe për të siguruar ofrimin e shërbimeve në standardet e kërkuara. Pra, nëse ndërmarrjeve u vendoset detyrimi për ofrimin e shërbimit publik, ajo mund t’u sjellë atyre humbje, të cilat duhet të mbulohen ose të kompensohen nga autoritetet publike.

Ka raste kur niveli i kompensimit që u jepet ndërmarrjeve për të ofruar një shërbim publik mund t’u krijojë atyre burimet e mjaftueshme për t’u sjellë në mënyrë antikonkurruese në treg, duke vendosur p.sh. çmime predatore dhe duke nxjerrë kështu jashtë loje aktorë të tjerë të tregut. Për këtë arsye, i gjithë procesi duhet të zhvillohet mbi bazën e kushteve dhe kritereve të përcaktuara qartë e në mënyrë objektive, si dhe të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë që mbështetja apo ndërhyrja nga ana e autoriteteve publike të jetë vetëm në masën e nevojshme dhe absolutisht të domosdoshme për të kompensuar ofrimin e shërbimit publik.

Ky udhëzim zbatohet për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik dhe lidhet me sektorin e prokurimeve publike, të konkurrencës, të transportit e punëve publike apo të transmetimeve telefonike e mediatike. Ai u vjen në ndihmë autoriteteve publike në sektorët që ofrojnë shërbime të tilla, për të hartuar politikat dhe për të përgatitur projektaktet e ndryshme normative që përcaktojnë apo ngarkojnë ndërmarrjet me detyrimin e ofrimit të shërbimeve publike, në përputhje me rregullat e ndihmës shtetërore.

Sipas legjislacionit të ndihmës shtetërore, do të konsiderohet shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik çdo veprimtari ekonomike e konsideruar nga organet shtetërore me interes të veçantë publik dhe që nuk mund të sigurohet pa ndërhyrjen e shtetit.

I. Kushte të përgjithshme

Ndihma shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik mund të lejohet vetëm nëse:

- i) përfituesit i është përcaktuar qartë detyrimi i ofrimit të shërbimit publik;
- ii) parametrat për llogaritjen e ndihmës përcaktohen paraprakisht në mënyrë transparente dhe objektive;
- iii) ndihma nuk tejkalon kostot e nevojshme për të siguruar ofrimin e shërbimit publik;
- iv) përfituesi është zgjedhur mbi bazën e procedurës së prokurimit publik;
- v) ndihma e nevojshme për kompensimin e ofrimit të shërbimit publik përcaktohet mbi bazën e kostos që do të kishte një ndërmarrje efiçente që ushtron veprimtarinë e saj në një sektor të tillë.

Ndërmarrje, që mund të përfitojë ndihmë shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve

me interes të përgjithshëm ekonomik, mund të jetë çdo person fizik ose juridik, privat ose publik, që kryen veprimtari ekonomike dhe/ose operon në fushën e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik.

Autoritetet publike janë përgjegjëse për të përcaktuar kuadrin ligjor në lidhje me kushtet dhe kriteret për ofrimin e shërbimit me interes të përgjithshëm, pavarësisht nga statusi ligjor i ofruesit të shërbimit (nëse është ndërmarrje private apo publike), si dhe për sigurimin e ofrimit të shërbimit, në përputhje me parimet e konkurrencës.

II. E drejta për ofrimin e shërbimit të interesit të përgjithshëm publik

E drejta për ofrimin e shërbimit me interes të përgjithshëm ekonomik mund t'u jepet ndërmarrjeve nga autoritetet publike me anë të kontratës së shërbimit publik.

Kontrata e shërbimit publik është e domosdoshme për të përcaktuar detyrimin si për ndërmarrjen në fjalë, ashtu dhe për shtetin. Me këtë të fundit nënkuptohen organet e administratës publike (në nivel qendror dhe vendor), që kanë si objekt të punës së tyre sigurimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik për konsumatorët apo përdoruesit.

Kontrata e shërbimit publik duhet të përmbajë:

- i) llojin dhe kohëzgjatjen e shërbimit publik;
- ii) ndërmarrjen përfituese (që ka detyrimin për ofrimin e shërbimit publik) dhe territorin në të cilin do të kryhet ky shërbim;
- iii) llojin e çdo të drejte ekskluzive dhe të veçantë që i jepet ndërmarrjes/ndërmarrjeve të ngarkuara me ofrimin e shërbimit publik;
- iv) kriteret për llogaritjen, kontrollin dhe rishikimin e kompensimit;
- v) çdo marrëveshje për shmangien dhe ripagimin e çdo mbi kompensimi.

Në përcaktimin e ofrimit të detyrimit të shërbimit publik dhe për vlerësimin e kryerjes së shërbimeve nga ndërmarrjet, autoritetet publike mund të konsultohen me përdoruesit apo konsumatorët.

III. Masa e kompensimit

Masa e kompensimit nuk duhet të tejkalojë koston e nevojshme për kryerjen e shërbimit publik, duke marrë parasysh faturën dhe një përfitim të arsyeshëm mbi çdo kapital të nevojshëm për të përmbushur këto detyrime.

Masa e kompensimit do të përfshijë çdo avantazh të dhënë nga shteti, nëpërmjet burimeve të tij në çdo lloj forme. Përfitimi i arsyeshëm do të marrë parasysh të gjitha ose disa përfitime produktive të arritura nga ndërmarrja, gjatë një periudhe të kufizuar të paracaktuar, pa ulur nivelin e cilësisë së shërbimit, që ndërmarrjes i është besuar nga shteti.

Në çdo rast, kompensimi do të përdoret vetëm për kryerjen e shërbimit publik. Në rast se kompensimi i dhënë për ofrimin e shërbimit publik përdoret për ushtrimin e veprimtarive të tjera nga ana e ndërmarrjes, ai do të konsiderohet ndihmë shtetërore e paligjshme. Megjithatë, ndërmarrja që përfiton kompensim për ofrimin e shërbimit publik, ka të drejtë të ketë një fitim të arsyeshëm.

Kostot që do të merren parasysh, përfshijnë të gjitha kostot që lindin gjatë ofrimit të shërbimit me interes të përgjithshëm ekonomik. Kur veprimtaria e ndërmarrjes konsiston vetëm në kryerjen e shërbimit me interes të përgjithshëm ekonomik, në konsideratë do të merret e gjithë kostoja e ushtrimit të kësaj veprimtarie. Ndërsa në rastet kur ndërmarrja kryen veprimtari të tjera përveç ofrimit të shërbimeve publike, do të merret parasysh vetëm kostoja e shërbimit me interes të përgjithshëm ekonomik.

Kostoja e përcaktuar për shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik mund të mbulojë:

- i) të gjitha ndryshimet e kostos që ndodhin gjatë kryerjes së shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik;
- ii) një kontribut përpjesëtimor të kostove fikse si të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, ashtu edhe të veprimtarive të tjera me një përfitim të arsyeshëm.

Nëse është e nevojshme për ofrimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, mund të merren parasysh edhe kostot për investime, veçanërisht ato të lidhura me infrastrukturën.

Kostot e lidhura me veprimtari jashtë qëllimit të ofrimit të shërbimit me interes të përgjithshëm publik duhet të mbulojnë:

- i) të gjitha kostot e ndryshueshme;
- ii) një kontribut të përshtatshëm për kostot fikse, si dhe
- iii) një rikthim të përshtatshëm të kapitalit.

Këto kosto, në asnjë rrethanë, nuk mund t'i ngarkohen shërbimit publik.

Llogaritja e kostove do të bëhet mbi bazën e kritereve të paracaktuara, duke respektuar parimet e gjithë pranuar të llogaritjes së kostove. Komisioni i Ndhmës Shtetërore do të njoftohet duke ndjekur rregullat e njoftimit të ndihmës shtetërore të parashikuar në rregulloren “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.817, datë 28.12.2005.

IV. Të ardhurat e përfituara nga ofrimi i shërbimit me interes të përgjithshëm ekonomik

Në të ardhurat e përfituara nga shërbimi me interes të përgjithshëm ekonomik do të përfshihen të gjitha të ardhurat që siguron ndërmarrja si rezultat i ofrimit të këtij shërbimi. Nëse ndërmarrja në fjalë gëzon të drejta të veçanta apo ekskluzive që lidhen me një shërbim të interesit të përgjithshëm ekonomik, i cili gjeneron fitime përtej masës së fitimit të arsyeshëm, ose përfiton përparësi të tjera që mund t'i jepen nga shteti, në llogaritjen e të ardhurave duhet të merren parasysh të ardhurat e krijuara nga të gjitha këto shërbime.

Përfitim i arsyeshëm është vlera e kthyeshme në kapitalin e vet, duke marrë parasysh rrezikun ose mungesën e tij për ndërmarrjen, që vjen si pasojë e ndërhyrjes së shtetit, veçanërisht nëse ky i fundit jep asaj të drejta të veçanta apo ekskluzive.

Kjo vlerë nuk duhet të tejkalojë normën mesatare të fitimit të llogaritur për vitet e fundit për sektorin, në të cilin kryhet shërbimi publik. Për sektorët ku nuk ka ndërmarrje të krahasueshme me ndërmarrjen së cilës i është besuar shërbimi publik, krahasimi bëhet me ndërmarrje të cilat veprojnë në shtete të tjera, ose në rast se është e nevojshme krahasimi bëhet me sektorë të tjerë, por gjithmonë duke mbajtur parasysh veçoritë e sektorit/sectorëve përkatës. Për përcaktimin e “fitimit të arsyeshëm”, dhënësit e ndihmës mund të përdorin kritere nxitëse, në veçanti, në lidhje me cilësinë e shërbimit si dhe me arritjen e një efience produktive.

Dhënësit e ndihmës mund të vendosin, gjithashtu, që përfitimi, i cili rrjedh nga një aktivitet tjetër jashtë qëllimit të shërbimit me interes të përgjithshëm ekonomik, të përdoret tërësisht ose pjesërisht për financimin e shërbimit me interes të përgjithshëm ekonomik.

Nëse ndërmarrja kryen veprimtari të tjera, të cilat mund të bien ose jo në fushën e shërbimeve të interesit të përgjithshëm ekonomik, fletë bilanci ose llogaria humbje-fitime, duhet të tregojë në mënyrë të qartë kostot dhe faturat që lidhen me shërbimin e interesit të përgjithshëm, të ndara nga ato që lidhen me veprimtaritë e tjera të ndërmarrjes. Gjithashtu duhet të pasqyrohen edhe të gjithë treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve. Pra ndërmarrja që ofron një shërbim të interesit të përgjithshëm duhet të ketë llogari të ndara për shërbimin në fjalë.

Nëse ndërmarrjes i është ngarkuar të kryejë disa shërbime të interesit të përgjithshëm ekonomik, qoftë për shkak se autoritetet që ia kanë ngarkuar këto shërbime janë të ndryshme, apo pasi natyra e shërbimeve të tjera të interesit të përgjithshëm është e ndryshme, llogaritë financiare të ndërmarrjes duhet të bëjnë të mundur që të verifikohet se nuk ka asnjë mbikompensim për secilin nga shërbimet e interesit të përgjithshëm ekonomik.

V. Kontrolli i mbikompensimit

Dhënësit e ndihmës duhet të kontrollojnë rregullisht ose të garantojnë kontrollin, që ndërmarrjet nuk po mbikompensohen. Meqenëse mbikompensimi nuk është i nevojshëm për kryerjen e shërbimit me interes të përgjithshëm ekonomik, ai në vetvete përbën ndihmë të paligjshme shtetërore dhe kjo ndihmë duhet të rimbursohet, pra të kthehet së bashku me interesat. Gjithashtu, kjo bën që për të ardhmen të rivlerësohen parametrat për llogaritjen e mbikompensimit.

Kur masa e mbikompensimit nuk i kalon 10% të masës së kompensimit vjetor, ky mbikompensim mund të mbartet për vitin pasardhës dhe të mbahet nga masa e kompensimit që do të paguhet për atë periudhë. Disa shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik mund të kenë një kosto që ndryshon çdo vit, veçanërisht për sa i takon investimeve të veçanta. Përgjithësisht në këto raste, mbikompensimi më shumë se sa 10%, në vite të caktuara, mund të shihet si i domosdoshëm për kryerjen e shërbimit të interesit të përgjithshëm ekonomik. Kjo situatë duhet të arsyetohet në mënyrë të detajuar me anë të njoftimit që do të bëhet pranë DNSH-së. Megjithatë, çdo rast do të rishikohet në intervale të përcaktuara mbi bazën e gjendjes së çdo sektori, por periudha e rishikimit, në asnjë rast nuk duhet të kalojë 4 vjet. Çdo mbikompensim që zbulohet në fund të kësaj periudhe do të kthehet.

Çdo mbikompensim mund të përdoret për të financuar një tjetër shërbim publik nga e njëjta ndërmarrje. Transferta duhet të pasqyrohet në llogaritë e ndërmarrjes, të jetë subjekt i kontrolleve dhe të ruhet në përputhje me rregullat dhe parimet e përcaktuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore. Transferta duhet të njoftohet paraprakisht pranë DNSH-së.

Shuma e mbikompensimit nuk mund të jetë e disponueshme për ndërmarrjet nisur vetëm nga fakti se ajo mund të kategorizohet si ndihmë e lejueshme, në bazë të legjislacionit të ndihmës shtetërore (siç mund të jetë ndihma për SME-të, për punësimin etj). Edhe nëse autoritetet publike mendojnë ta kategorizojnë si të tillë, ato duhet të ndjekin të gjitha procedurat dhe kushtet e parashikuara në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore” dhe rregulloret në zbatim të tij.

VI. Kushte dhe detyrime

Në fushën e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, Komisioni i Ndhmës Shtetërore mund të vendosë kushte ose detyrime që janë të nevojshme, veçanërisht për të siguruar që ndihma që ju jepet ndërmarrjeve të mos sjellë mbikompensim. Përveç kërkesës për ndarjen e llogarive, mund të vendosen kushtet e raportimit periodik, ose edhe kushte të tjera, sipas rastit apo sektorit ku kërkohet të ofrohet shërbimi i interesit të përgjithshëm.

Gjithashtu Komisioni i Ndhmës Shtetërore propozon marrjen e masave të përkohshme për skemat ekzistuese që lidhen me shërbimet e interesit të përgjithshëm, duke kërkuar përshtatjen e tyre me legjislacionin e ndihmës shtetërore.

Dhënësit e ndihmës duhet të shprehen për pranimin ose jo të masave të përkohshme. Kur dhënësi pranon masat e propozuara, drejtoria e regjistron këtë fakt dhe informon me shkrim dhënësin. Dhënësi është i detyruar me këtë pranim që të zbatojë masat përkatëse.

Kur dhënësi nuk pranon masat e propozuara dhe Komisioni, pasi ka marrë parasysh argumentet e dhënësit të interesuar, vazhdon t’i vlerësojë të nevojshme këto masa, ai mund të vendosë fillimin e procedurave për ndihmën e paligjshme.

VENDIM

Nr.63, datë 13.6.2008

MBI APLIKIMIN E SHOQËRISË “ERS-08” SHPK PËR LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARKU EOLIK KAVAJË

Në mbështetje të neneve 9, 13, pikat 1 germa “a”, dhe 8, si dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 5, 13, pika 1 dhe 2, si dhe 14, të “Rregullores për procedurat e licencimit”, miratuar me vendimin nr.24, datë 4.4.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.6.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ERS-08” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike, nga parku eolik Kavajë,

konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të ERS-08 sh.p.k., ka nisur me marrjen e vendimit nr.29, datë 4.3.2008.

2. Ligji nr.9913, datë 5.5.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike””, nuk mund të ketë fuqi prapavepruese për aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Në lidhje me ndërtimin e këtij parku, shoqëria ERS- 08 sh.p.k., në aplikimin e saj për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike, e bazon studimin e prefizibilitetit në të dhëna historike të regjistruara të ERE-s, të matura në lartësi të ndryshme nga ato në të cilat do të punojnë gjeneratorët.

4. Ligji për sektorin e energjisë elektrike parashikon në nenin 15 autoritetin e ERE-s për vendosjen e kushteve të çdo licence.

Për sa konstatuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga Parku Eolik

Kavajë me kusht zbatimin përveç sa parashikuar në licencën tip të miratuar nga Bordi i Komisionerëve për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, edhe të zbatimit të kushteve të mëposhtme:

a) Kryerjen e një studimi fisibiliteti, që kushtëzohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Përcaktimi në këtë studim i kostos së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE brenda 12 muajve nga data e lëshimit të licencës dhe përpara fillimit të zbatimit të punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.

b) Shoqëria “ERS-08” sh.p.k. duhet paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjella, që rrjedhin nga kodi i transmetimit.

c) Shoqëria “ERS-08” sh.p.k. do të respektojë detyrimet e shërbimit publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

d) Koha e zbatimit e të gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke iu referuar datës së lëshimit të licencës të jetë 36 muaj.

e) Mospërmbushja e pikave të mësipërme në afatet e përcaktuara e bën licencën të pavlefshme.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.64, datë 13.6.2008

MBI APLIKIMIN E SHOQËRISË “ERS-08” SHPK PËR LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERË DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARKU EOLIK LEZHË

Në mbështetje të neneve 9, 13, pikat 1 germa “a”, dhe 8, si dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13, pika 1 dhe 2, si dhe 14, të Rregullores për procedurat e licencimit”, miratuar me vendimin nr.24, datë 4.4.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.6.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ERS-08” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike, nga parku eolik Lezhë,

konstatoi se:

1. Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., ka nisur me marrjen e vendimit nr.29, datë 4.3.2008.

2. Ligji nr.9913, datë 5.5.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike””, nuk mund të ketë fuqi prapavepruese për aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Në lidhje me ndërtimin e këtij parku eolik, shoqëria “ERS-08” sh.p.k. në aplikimin e saj për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë dhe prodhimin e energjisë elektrike, nuk ka paraqitur dokumente që vërtetojnë pronësinë e aseteve për zonën ku shtrihet parku eolik Lezhë, duke mos plotësuar nenin 9 pika 2 germa “e” të “Rregullores për procedurat e licencimit”, një nga kushtet bazë për ushtrimin e aktivitetit që kërkohet të licencohet.

Për sa konstatuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Refuzimin e licencimit të shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga parku eolik Lezhë.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.67, datë 20.6.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BIOPOWER
GREEN ENERGY” SHPK (PARK EOLIK BPGE1)**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pikat 1 germa “a”, dhe 8, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 8 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datë 4.4.2007, dhe neneve 18 pika 3 dhe 19 pika 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007, në mbledhjen e tij të datës 20.6.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimit të energjisë elektrike (park eolik BPGE1),

dhe konstatoi:

- Paraqitjen, konform përcaktimeve të rregullores së procedurave të licencimit, të dokumentacionit dhe deklaratave të kërkuara nga ERE kur dokumentacioni mungon.

- Me vendimin nr.64, datë 13.6.2008, Bordi vendosi ta refuzojë licencimin e shoqërisë “ERS 08” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimit të energjisë elektrike, (Park eolik Lezhë, i cili përputhej me zonën e studiuar nga shoqëria Biopower Green Energy për Parkun BPGE1).

- Ligji nr.9913, datë 5.5.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike””, nuk mund të ketë fuqi prapavepruese për aplikimet e paraqitura para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

- Është shuar kushti për pezullimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të paraqitur nga shoqëria “Biopower Green Energy” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimit të energjisë elektrike (Park eolik BPGE1).

Për sa konstatoi më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike (Park eolik BPGE1).

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.75, datë 26.6.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES ME SHUMICË TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” pika 4.13 germa “a”, pika 2, vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.61, datë 4.6.2008 “Për fillimin e procedurave të përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuesit publik me shumicë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.6.2008, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve në lidhje me kërkesën e KESH sh.a. me nr.DEK/IZ 3061 prot, datë 26.5.2008 për përcaktimin e tarifës së shitjes me shumicë të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi publik me shumicë (KESH sh.a.) te furnizuesi publik me pakicë (OSSH sh.a.) të jetë 1.61 lekë/kWh për periudhën 1 korrik 2008 deri më 28 shkurt 2009.

2. Për efekt të rakordimeve të detyrimeve që lidhen me ndarjen e aktiviteteve të OSSH sh.a. dhe KESH sh.a., ky çmim mund të aplikohet nga palët duke nisur që nga fillimi i vitit 2008.

3. Ngarkohet Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, si dhe Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për ta njoftuar KESH sh.a.-së dhe OSSH sh.a.-në mbi vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 1 korrik 2008.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.76, datë 26.6.2008

**PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË NJËJTË DHE TË STANDARDIZUAR TË LLOGARIVE
PËR TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, 21 dhe 23 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 26.12.2007 “Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të sistemit të njëjtë të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 26.6.2008, pasi shqyrtoi draftin e sistemit të njëjtë dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave,

VENDOSI:

1. Miratimin e sistemit të njëjtë dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike. (Materiali bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim i shtrin e efektet që nga data 1 janar 2008.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.77, datë 26.6.2008

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFËS PËR
KOMPANINË PUBLIKE TË GJENERIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, 26 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.35, datë 21.3.2008 “Për fillimin e procedurave të miratimit të metodologjisë të llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit, metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike, metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe metodologjisë të llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 26.6.2008, pasi shqyrtoi draftin e metodologjisë të paraqitur,

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit, të energjisë elektrike. (Metodologjia bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.78, datë 26.6.2008

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFËS PËR
FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, 26 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.35, datë 21.3.2008 “Për fillimin e procedurave të miratimit të metodologjisë së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit, metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike, metodologjisë, të llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 26.6.2008, pasi shqyrtoi draftin e metodologjisë së paraqitur,

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike. (Metodologjia bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.79, datë 26.6.2008

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFËS SË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, 26 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.35, datë 21.3.2008 “Për fillimin e procedurave të miratimit të metodologjisë së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit, metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike, metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 26.6.2008, pasi shqyrtoi draftin e metodologjisë së paraqitur,

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës të shpërndarjes të energjisë elektrike. (Metodologjia bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.80, datë 26.6.2008

**PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFËS PËR
FURNIZUESIN PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9, 26 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22. 5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.35, datë 21.3.2008 “Për fillimin e procedurave të miratimit të metodologjisë së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit, metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike, metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 26.6.2008, pasi shqyrtoi draftin e metodologjisë së paraqitur,

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike. (Metodologjia bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

KËRKESË
Nr.4301, datë 11.6.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për pasurinë që preket nga ndërtimi i unazës Shkodër (dy kolektorët dhe sipërfaqet e truallit në banesa). Subjekti kërkuar i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrëat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

LISTA E PRONARËVE TË CILËT DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË UNAZËS SHKODËR (DY KOLEKTORËT DHE SIPËRFAQET E TRUALLIT NË OBJEKTE)

Nr.	Emri	Sipërfaqja toke truall m ²	çmimi l/m ²	Vlera në lekë	Konfirmim i ZVRPP	Shënime
1	Haki Hoxha	16	21 564	345 024		Plotësim dokumentacioni
2	Kujtim Ferhati	5	21 564	107 820		Plotësim dokumentacioni
3	Nazmi Kruja	45.5	13 429	611 020	I pakonfirmuar	Plotësim dokumentacioni
4	Mersin Jahja	11	21 564	237 204		Plotësim dokumentacioni
5	Medi Duda	25	21 564	539 100	I pakonfirmuar	Plotësim dokumentacioni
6	Mithat Duda	50	21 564	1 078 200		Plotësim dokumentacioni
7	Ahmet Osja	15	21 564	323 460		Plotësim dokumentacioni
8	Xheladin Zerdelia	15.5	21 564	334 242		Plotësim dokumentacioni
9	Selaudin Jakupi	9.5	21 564	204 858		Plotësim dokumentacioni
10	Fadil Pirani	25	21 564	539 100		Plotësim dokumentacioni
11	Smajl Shyti	14	21 564	301 896		Plotësim dokumentacioni
12	Petrit Barbullushi	32	13 429	429 728		Plotësim dokumentacioni
13	Bashkëpronarët Anamali	665	13 429	8 930 285		Plotësim dokumentacioni
14	Bashkëpunëtorët Lluja	205	13 429	2 752 945		Plotësim dokumentacioni
15	Shuma			16 734 882		

Vlera totale e këtij shpronësimi është 16 734 882 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekë.

Për pronarët për të cilët është bërë shënimi “i pakonfirmuar” të sillet dokumentacioni i pronësisë brenda 15 ditëve nga data e publikimit në gazetë, në rast të kundërt do të përjashtohet nga shpronësimi.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr.458, datë 7.5.2008, shpall të vdekur shtetasin Bashkim Aqif Gorovelli, i datëlindjes 20.7.1962, me datë vdekjeje 1.10.1998.

KËRKESË

Shtetësja Rakibe Stafa, e bija e Jahos dhe e Mendimes, e datëlindjes 25.1.1950, lindur në Korçë dhe banuese në lagjen “Dyli Haxhire”, rruga “Qemal Stafa”, pallati nr.403, Elbasan, kërkon shpalljen të zhdukur të vajzës së saj, Suzana Stafa.

KËRKUESJA
Rakibe Stafa

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 1.7.2008
Doli nga shtypi më 1.7.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 40 lekë